

Mendimi ynë, gjithnjë merret në konsideratë Bashkëbisedim me Kryetarin e Sindikatave të Pavarura të Rrethit Z.Agustin Markaj)



Z. Agustin: Si fillim mirësevini në faqet e gazetës "Malësia", ndërsa së dyti deshëm t'ju kërkojmë ndjesë ngaqë patjetër ndjeheni disi i "fyer" nga haresa jonë për të vetmen sindikatë të fuqishme në rreth, e në të njëjtën kohë duke patur kurajon që të bëjmë autokritikë, t'ju ftojme për një intervistë të shkurtër me anën e së cilës të mësojmë diçka me tepër mbi aktivitetin e sindikatës që ju drejtoni.

Pyetje: Kur është krijuar Sindikata Juaj dhe cili ka qënë aktiviteti i saj?

Përgjigje: Me ndarjen e rrethit si njesi administrative me vehte, ne kemi funksionuar si filiale të Shkodrës, dhe të gjitha ato filiale bënin jetën sindikale në qytetin e Shkodrës, kjo deri në ndarjen e Rrethit. Ka qënë një grup nismëtarësh, nga të cilët mund të përmend Lan Hysen, nga Ujësllësi, Nush Smakaj nga arësimi, Din Ramaj nga Shëndetësia, Lutfije Çomo etj, që me datën 6 Prill të vitit 1992 krijuam sindikatën e pavarur të Rrethit Malësi e Madhe. Që nga ajo kohë unë jam zgjedhur kryetar i asaj sindikate.

Pyetje: Kanë kaluar metepër se katër vjet që atherë, dhe përsëri rrethi i M.Madhe ka tepër probleme. Sa është prezente sindikata juaj?

Përgjigje: Sindikata jonë është më e fuqishme në rreth dhe shtrihet në të gjitha ndërmarrjet dhe subjektet private të rrethit tona. Rreth 3000 anëtar janë antarë me dokumente të rregullta pranë kësaj sindikate. Me të tri firmat private më të fuqishme kemi të lidhura kontratë të r-

regullt dhe po bojmë përpjekje për kontraktime edhe me subjektet e tjera private. Gjatë punës tonë kemi patur mjaft atakime me Këshillin e rrethit, telekomin, ujësjellsin, ndërmarrjen e ujërave, shëndetësinë etj, për të cilat në shumicën e rasteve është marrë parasysh edhe fjala jonë. Probleme kemi patur me ndërmarrjen e ujësjellsit, sidomos për pengesat e punëtorve, ku është drejtor zoti Xhelal Malcaj.

Pyetje: Ka disa ndërmarrje që nuk varen nga rrethi i Malësisë së Madhe, dhe thuhet se mjaft nga puntoret i kanë marrë nga shkodra. Si e shef këtë problem kryetari i sindikatës që mbron punonjësit e vet?

Përgjigje: Është e vërtetë.

Në rrethin tonë vazhdojnë të ushtrjnë aktivitetin e tyre Ndërmarrja e Stacionit hekurudhor të Bajzës që ka drejtorinë në Shkodër dhe Drejtoria e Doganave që ka qendrën po në Shkodër. Ata rreth 80% të punonjësve, deri edhe punonjës të thjeshtë i marrin nga shkodra dhe as që përfillin fare mendimin e sindikatës tonë. Po ashtu edhe Telekomit sjell inxhinjerë e punonjës të tjerë nga Shkodra, kur kemi të tjerë të papunë në rrethin e Malësisë. Gjithashtu mjaft kërkesa kemi bërë për sjelljen e gjykatës, Prokurorisë dhe hetuesisë nga Shkodra, që me pa të drejtë qesin vështirësi e pengesa për banorët e rrethit tonë.

Pyetje: Z.Agustin, me dekret Presidential edhe Kampi i Razmen ka me tepër se tri vjet që administrohet nga ana juaj. A

jeni ndopak të proekupuar për fatet e atij kampi pasi mesa shohim ai nuk mund të quhet me si i tillë.

Përgjigje: Keni të drejtë se ashtu po ndodh ertet. Ne e kemi akoma të administrim por jo çdo që është në dorën tonë, pasi me vendim të komisionit të kthimit të pronave në rreth të trembëshjet vilat e lampit u janë kthyer ish-proarëve të truallit. Kjo ka qënë në kundërshtim me vendimin e Qeverisë dhe Dekretin Presidential që e kanë shpallur Razmen zonë turistike. Ne e kemi kundërshtuar me forcë një vendim të tillë dhe jemi ankuarleri në Këshillin e Përgjithshëm të Sindikatave të Pavarura të Rrethit. Dhe përsëri thuhet se kampi do të rihet i tillë, megjithë që i gjithë personeli i tij së bashku me Drejtorin janë kthyer në roje të pasurisë.

Pyetje: Cilat do të ishin disa nga shqetësimet e sindikatës për kushtet aktuale?

Përgjigje: Disa nga problemet kryesore që në një të ardhme të shpejtë duhet të gjejnë zgjidhje konkrete mund të përmend: Punësimin që akoma është në shifra tepër të ulta, nevojën e investimeve më të mëdha në infrastrukturën e rrethit, e cila duhet rranuar se është në nivele të minimale, rritjen e pagëve për arësimin dhe shëndetësinë, kompesimin real të çmimit të bukës dhe rritjen disa herë të pensione për invalidet partizantë dhe familjet e tyre, ish përndjekurit politik dhe të persekutuarit etj.

Gjithashtu nuk do të reshtim se kërkimi ardhjen në qendrën e rrethit tonë të institucioneve që aktualisht janë në Shkodër, si dhe punësimin në to institucione të punonjësve dhe specialistëve nga rrethi ynë.

Pyetje: Çfarë do tu uroni sindikalistëve dhe të gjithë lexuesve të gazetës "Malësia" nëpërmjet faqeve të saj?

Përgjigje: Në radhë të parë dua t'ju përshëndes juve si staf drejtues i gazetës, jo vetëm se me ne fund u kujtuat se ka edhe sindikata, por për kurajon dhe guximin që kemi në trajtimin me realizëm të mjaft problemeve që sot proekupojnë Malësinë e Madhe. Uroj që të ecni edhe më përpara në rrugën e nisur, e me kete rast pershendes të gjithë sindikalistët që aderojnë në sindikatën tonë, bashkë me ta edhe të gjithë lexuesit e gazetës "Malësia", dhe t'i uroj për më shumë fat dhe suksese në të ardhmen, por më shumë besim tek Progresi dhe Qeveria Jonë Demokratike. Ju faleminderit!

Bisedoi Kr.KOPLIKU

"Kuajt" qe çuan në Amerikë Gjeke Marinën Kuajt



Ishte një poezi e vetme e titulluar "Kuajt", e cila u botua në një cep të gazetës se shkrimtarve dhe artistëve "Drita", aty nga fillimi i vitit 1990 e cila për nga madhështia e saj i bëri lexuesit të pyesin: Kush është, nga është autori i saj, deri atë ditë krejtësishtë i pa njohur. Dhe është me se e vërtet, se as ne kolegët e tij që rinin veçanti për poezinë, sikur nuk e donim ta besonim se autori i kësaj poezie që u bë hymen për studentët e dhjetorit është Gjeke Marinaj. Ky djalosh i cili u lind në malet e kastroit, zbriti në fushën e Bajzës dhe jetoj për vite me rradhë në një shtëpi kasolle në varfërinë e tejskajshme që "sillinin" vitet e "ndritura" të partisë nuk e mundonte duronte dhe, urrejtjen e shprehte me vargje, me armën e fortë të poezisë. Ashtu në luftë me varfërinë arriti të mbaroj shkollën e mesme teknologjike në Shkodër.

Dhe menjëherë mbas botimit të poezisë "Kuajt" Gjeke vihet në shijnjës të sekretarëve të komitetit të partisë në Shkodër, të kallëpit Gjorgj Grabova dhe ...Gjeke zgjodhi rrugën e shpëtimit si shumë të rinj të tjerë shqiptar, atë të "tradhtisë ndaj Atdheut". Tani jeton dhe punon, madje dhe studion në një universitet në Dallas të SHBA. Atje ai studion për gazetari. Ka botuar një libër me poezi të titulluar: mos me ike large, ka gati librin e dytë me poezi, si dhe një roman. Për kënaqësin e adhurusve të poezisë ne zgjodhëm nga libri: Mos me ike largë, këto poezi që po botojmë.

Ndaj dhe ne i urojmë krijimtari të mbarë dhe shendet kolegut tonë Gjeke Marinaj.

Redaksia

Tërë jetën duke vrapuar rrimë
Shohim veç përpara
Ç'bëhet prapa s'duam l'ia dimë.
Ne nuk kemi emër
Të gjithëve kuaj na thonë,
Nuk qajmë
Nuk qeshim,
Heshim,
Dëgjojmë,
Hamë atë ç' na japin,
Ecim nga na thonë,
Asnjë nga ne s'është mendje hollë
Kush qe kalë mbreti,
Posti qe i lartë
Kush qe kalë princeshe
I bënë shalë të artë
Kush qe kalë fshatari
Pat samarë me kashtë
Kush qe kalë i egër
Tërë jetën fjeti jashtë
Po qemë dhe mbetëm kuaj, para njeriut!

Mos më ik larg poezi

Krejt i vogël më ngjan vetja,
sa çap në rrugën tënde
diku, duke provuar djegjen e lehtë
të një luthre
diku, duke ndërë dhëmbjen e shpimit
të një gjembi
diku, duke lundruar mbi ca fletë
të çuditshme drite.

Herë eci ngarkuar hundebuzë
me një melankoli të tërbuar
si luan kështu me mua, poezia ime,
tempulli im?!
Ti e di se gjithmonë jam magjepsur pas
çudirave të poetëve
KA kohë, pa vënë re, për tek ti imitoj
rrokullisjet e orteqeve,
se dua të rritem, të rritem patjetër.
Nisem nga cepi i mëngjesit
për tek mbrëmja e rrëzimit të ditës
dhe ëmbëlsia e vajzës që dua
dhe lodhem duke ndjekur me njerëzit
gjurmët e zhdukshme të diellit
dhe prapë rrokullisjen mbushëse drejt teje
na udhëshpejton dëshira për të të
përqafuar...
Kujdes, mos më lëndo shumë duke më ikur
larg,
poezia ime- tempulli im!

Në diskotekën Nr.104 të Dallasit

Muzika godet me tinguj tavanet
si me gurë,
Asnjë e çarë.
Të rinjtë prekin dyshemenë
si muzikantët organot,
Asnjë notë e humbur
Shtëpitë e vullkaneve
në gjokset e vajzave,
Asgjë rrëzuar.
Në sytë e djemve
magjitë e lëkundjeve,
Asnjë komçë zbrërthyer
Kryqëzohen gishtërinj,
enden puthje,
Asgjë e çuditshme,
Një vajzë sypoezi,
edhe mua,
në cep të buzëqeshjes më vari
një vals...
por unë diçka më i trashë
se tymi i duhanit në sallë!...